



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.372/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Faton Ademi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rexhep Mazreku, kandidat për deputet nga radhët e koalicionit AAK-PSD, dega në Malishevë, paraqitur kundër komisionerëve të Vendvotimeve: Nr.3019A/02D, Nr.3028A/01R, Nr.3028A/02R, Nr.3028A/03D, Nr.3035A/01R, Nr.3035A/02D, Nr.3048A/01D, Nr.3045/01, Nr.3045/02D, për shkak të mungesës së votave gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 15.10.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**HUDHET** e pa rregullt ankesa Anr. 372/2019, e datës 14.10.2019, e parashtruar nga Rexhep Mazreku, kandidat për deputet nga radhët e koalicionit AAK-PSD, dega në Malishevë, për shkak të mungesës së votave gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019.

## A r s y e t i m

Me datën 14.10.2019, PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.372/2019, të parashtruar nga Rexhep Mazreku, kandidat për deputet nga radhët e koalicionit AAK-PSD, në të cilën ka kërkuar që të verifikohen pikat nr.3019A/02D, ku në proces janë 02 vota, ndërsa në rastin e konfirmimit të votave thekson se ka pasur 54, në pikat Bellanicë 3028A/01R, 3028A/02R, 3028 A/03D, më tej thekson se janë të njoftuar dhe ka konfirmim për 45 vota, në pikat Llozicë me numër 3035 A/01R, është 00, në 3035 A/02D, janë 8 vota, ndërsa konfirmimi thekson se i ka ardhur për 35 vota, në pikën 3048A/01D, thekson se janë 27, derisa konfirmimi 43, në pikën 3045/01 Lladroviq, 3045/02D, thekson se janë 29 vota, ndërsa konfirmimi thekson se është për 77 vota.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

### **Ankesa është e pa rregullt**

Paneli, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesa e paraqitur nga Rexhep Mazreku, kandidat për deputet nga koalicioni AAK-PSD, është e parregullt, sepse ankesa në fjalë nuk është e

nënshkruar nga parashtruesi i ankesës dhe si e tillë ankesa nuk i plotëson kërkesat ashtu siç parashihet me nenin 5.6 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, ku theksohet se: “Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari”.

Prandaj Paneli, nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëcekura.

Nga arsyet e lartëcekura e në mbështetje të nenit 5.6 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.372/2019 më datën 15.10.2019.



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.